Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					



---

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shënim: Për plotësimin në mënyrë të saktë të shtojcës nr.2 (të ofertës ekonomike të detajuar) Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet ti referohen preventivave do të bashkëngjitura në DST e rçedurës me objekt “Rikonstruksion i shtepizave te mbeshtetura ne Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore”, me REF-58877-02-13-2023**

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose originë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

**Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet ti referohen preventivave do të bashkëngjitura në DST e rpeçdurës me objekt “Rikonstruksion i shtepizave te mbeshetura ne Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore”, me REF-58877-02-13-2023 të cituara si më poshtë.**

- |   |   |
|---|---|
| ➤ Projekt HVAC godina e re                          | ➤ Puntoria analiza                                |
| ➤ Projekt HVAC godina ekzistuese                    | ➤ Raport VNM Spitali Psikiatrik Vlore             |
| ➤ Projekt i instalimeve elektrike godina e re       | ➤ Relacion ark 2                                  |
| ➤ Projekt i MKZ godina e ekzistuese                 | ➤ Relacion Teknik hidrosanitar object i propozuar |
| ➤ Projekt konstruktiv formatuar                     | ➤ Relacion Teknik hidrosanitar objekti ekzistues  |
| ➤ Projekt arkitektures godina e propozuar           | ➤ Relacion Teknik HVAC object i propozuar         |
| ➤ Projekt arkitektures godina ekzistuese            | ➤ Relacion Teknik MKZ object ekzistues            |
| ➤ Projekt hidrosanitar godina e ekzistues           | ➤ Relacion Teknik ark.1                           |
| ➤ Projekt hidrosanitar godina e propozuar           | ➤ Relacion Teknik elektrik objekti ekzistues      |
| ➤ Projekt i instalimeve elektrike godina ekzistuese | ➤ Relacion Teknik elektrik objekti i propozuar    |
| ➤ Projekt i MKZ godina e propozuar                  | ➤ Relacion Teknik HVAC object ekzistues           |
| ➤ Projekt konstruktiv shtesa anesore SPV.           | ➤ Relacion Teknik MKZ object i propozuar          |
| ➤ Preventivi pa çmime god.femra                     | ➤ Grafiku I punimeve                              |
| ➤ Preventivi pa çmime god.meshkuj                   | ➤ Harta e rilevimit A3                            |
| ➤ Preventivi pa çmime permbledhesja                 |   |

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
	<b>“Supervizion për rikonstruksionin e shtëpizave të mbështetura”</b>	2,218,272.07 (Dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë 07) Lekë pa TVSH	<b>Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore”</b>	10 muaj

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Supervizion për rikonstruksionin e shtëpizave të mbështetura**

#### Detyrat: **1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit**

1.1 Mbikqyresi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjejë mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

#### **2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyresit**

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyresi menjëherë mbas lidhjes së kontratës dhe fillimeve të punimeve duhet:

- Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit përgjegjës dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislativës në fuqi. (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt. 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt. 22.02.2005, UKM Nr. 2, dt. 13.05.2005).
  - Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilesinë e punimeve.
  - Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyresi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plote në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyres mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.
- 2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Përgjegjës, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.
- 2.3 Mbikqyresi ve në dijeni Autoritetin Përgjegjës për nenkontraktoret e mundshëm që zgjedh Sipërmaresi (Zbatuesi i Punimeve) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
- 2.4 Mbikqyresi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislativën në fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998).

#### **3. Detyrat e mbikqyresit**

3.1 Mbikqyresi ka për detyrë:

- Te beje verifikimin e te gjithë dokumentacionit perkates te licensave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
  - Te beje verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe gati per te filluar punimet.
  - Te njihet me hollesi me kontraten e zbatimit te punimeve dhe te gjithë akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
  - Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:
    - Emertimi i objektit:
    - Data e marrjes se lejes se ndertimit:
    - Investitori:
    - Projektuesi:
    - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
    - Mbikqyresi:
    - Afati i ndertimit te objektit:
    - Vlera e objektit:
- 3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:
- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.
  - Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:
    - Stafi i Sipermarresit
    - Makinerite qe do perdoren per ndertimin e objektit
    - Pikat e marrjes se lendeve te para inerte
    - Zonat e ngritjes se kantjerit
  - Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.
  - Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Përgjegjës zgjidhjet konkrete.
  - Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacione qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve, miratimin e analizave te veçanta, duke dhene udhezime, porosi e urdhera per zbatimin me perpikmeri e ne kohe te projektit, te kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te dispozitave perkatese te kontratave.
  - Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piktimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.
  - Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje proces-verbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.
  - Ne çdo fund dite pune te kontrolloje ditarin e punimeve dhe te firmose ate.
  - Te kontrolloje librezen e masave, e cila verteton volumin e punimeve dhe ta miratoje ate.
  - Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.
  - Gjate zbatimit te projektit, i jep udhezime me shkrim Sipermaresit, sa here qe e sheh te nevojshme dhe Sipermaresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit, ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me udhezimet dhe urdherat e marra.

- Per çdo rast, qe gjate zbatimit te punimeve lind nevoja e ndryshimeve ne projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqese Autoritetit Përgjegjës nje relacion te plote teknik, shoqeruar me skicat perkatese ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi ne object, gjate zbatimit te punimeve, do te behet vetem pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor (Përgjegjës).
- Ne çdo fund muaji, Mbikqyresi ka per detyre te paraqese prane Autoritetit Përgjegjës raport mujor te punimeve. Ne kete raport duhet te jepet nje tablo e qarte e progresit te punimeve dhe te pagesave te kryera, realizimi i punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
- Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.

### 3.3 Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proçeseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike<sup>2</sup>,
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Përgjegjës)



- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale teknike, sociale
- Konkluzione

#### **4. Pergjegjesite e Mbikqyresit**

- 4.1 Ne fillim te punimeve Mbikqyresi mban dhe ka pergjegjesi per dokumentacionin e meposhtem:
- Vendimin e sheshit e ndertimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
  - Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sebashku me specifikimet teknike.
  - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te bazamentit ku do te kryhen punimet.
  - Dokumentacionin per realizimin e punimeve te objektit sipas projektit, kushteve teknike te zbatimit ne fuqi dhe specifikimeve teknike.
  - Saktesine e vertetesine e dokumenteve, volumet dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
  - Per realizimin me korrektesi te kontrates se nenshkruar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, per realizimin e te gjitha fazave te zbatimit te punimeve, respektimit te afatit te dorezimit si dhe te kostos se objektit.
  - Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet te njoftoje Mbikqyresin kur eshte gati per t'u ekzaminuar prej tij.
  - Ruajtjen e te gjitha dokumentacionit dhe korespondencen me Autoritetin Kontraktor, urdherat e ndryshme qe ai ka dhene gjate zbatimit te kontrates, kundershite dhe kontradiktat e lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe i kane diktuar keto nderprerje, relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit, si dhe te gjitha rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve.
  - Ne rast se gjate zbatimit te kontrates kemi ndërrim te Mbikqyresit, per dorezimin e gjitha dokumentacionit qe disponon Mbikqyresi, i gjitha dokumentacioni dorezohet me proces-verbal ku shenohen dhe shkaqet e ketij nderrimi.

#### **5. Te drejtat e Mbikqyresit**

- 5.1 Mbikqyresi ka te drejte:
- Te kerkoje largimin nga puna te Drejtuesit te Kantierit ose te punetoreve te veçante per mosbindje, paaftesi ose pakujdesi te rende.
  - Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
  - Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
  - Te kerkoje çertifikatat e cilesise se pajisjeve qe kryejne testet e materiale.
  - Te kerkoje dhe te asistojne ne kryerjen e provave te materialeve, per te verifikuar cilesine e tyre. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
  - Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise dhe ti zevendesojte ato me materiale te tjera nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
  - Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.

- Te mos lejoje perdorimin e makinerive dhe pajisjeve te ndryshme nqs ato jane jashte kushteve teknike.
- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyesi keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shtese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellimeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyesi i punimeve mendon se ka demtime ne konstruksion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyesi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyesi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Përgjegjës per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajtit, Mbikqyesi se bashku me Autoritetit Përgjegjës dhe Sipermarresin percaktojne zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Te kontrolloje dhe autorizojte perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Përgjegjës per gjendjen e tij. Ne rast se Autoriteti Përgjegjës ka verejtje e njofton Sipermarresin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyesi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Përgjegjës.

## 5.2 Ne perfundim te punimeve Mbikqyesi:

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proces-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Përgjegjës it dokumentacionin perkates.
- Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij.

## 5.3 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit
- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Kontraten e Sipermarrrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik per punime te paparashikuara

- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
  - Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
  - Ditarin e objektit ku te pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikqyresi
  - Librezen e masave
  - Shkresen e Mbikqyresit per investitorin ku raporton perdorimin e fondit rezerve, shoqeruar me dokumentacionin perkates
  - Proçes-verbalin e perdorimit te fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Preventivin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Situacionin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Çertifikatat e cilesise se materialeve
  - Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
  - Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
  - Regjistrin e kontabilitetit
  - Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
  - Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
  - Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
  - Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit
- 5.4 I gjithë dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje.
- 5.5 Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit qe ngrihet brenda 30 diteve nga perfundimi i objektit. Te gjithë dokumentat qe dorezohen prane grupit te kolaudimit duhet te jene origjinale.
- 5.6 Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet grupit te kolaudimit per te gjithë dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjetër, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Sipermarresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Përgjegjës.

## **6. Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes**

- 6.1 Sherbimi i mbikqyrjes zgjat per gjithë periudhen e zbatimit te punimeve.
- 6.2 Autoriteti Përgjegjës ka te drejte te kerkoje largimin e Mbikqyresit kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:
- Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara
  - Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
  - Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara, tolerim te materialeve jashte cilesise se kerkuar, tolerim te punimeve jo me cilesine e kerkuar, tolerim te pajisjeve jashte kushteve teknike
  - Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Përgjegjës ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, vendosen sanksione ne baze te legjislacionit ne fuqi.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Në rast se grupe operatorësh ekonomik mund të dorezojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat I vetëm për qëllimin e dorëzimit të ofertës në pjesëmarrje. Vetëm në rastet pasi të jenë shpallur fitues dhe vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës duhet të paraqesin forma ligjore specifike si më poshtë:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

### **Shënim:**

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ,, ku parashikohet :

*“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,*

si dhe përcaktimeve të **pikës 6**, të këtij neni:

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor (Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore) i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

**Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.**

---

**Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm si dhe:**

- a. Marrëveshja e **noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme e **noterizuar**.
- c. vërtetimet e pasqyruara apo dokumentacionin mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Vetëm në rastet pasi të jenë shpallur fitues dhe vleresohet e nevojshme për realizimin kontratës duhet të paraqesin forma ligjore specifike.

Shënim: Në akt marrëveshje të përcaktohen qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë, për tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi, ose për kategori punimesh të veçanta, gjithnjë në raport me %-en e deklaruar.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formulari i ofertes sipas Shtojces 1*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3,;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 8).

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet, konkretisht jo më e vogël se 2,218,272.07 (Dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjet e dy pikë 07) Lekë pa TVSH.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e

këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së **fondit limit që prokurohet** konkretisht, në vlerën **887,309** (Tetëqind e tetëdhjet e shtatë mijë e treqind e nëntë) leke pa tvsh, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

- a) Kur kontrata është realizuar me institucione shtetërore, ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nenshkruar, vërtetim për realizimin me sukses** nga institucioni me të cilin është lidhur kontrata të shoqëruar me **faturen tatimore**.
- b) Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nenshkruar dhe faturat tatimore** ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

### 2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë, lidhur me shërbimin e mbikqyrjes:

Bazuar në V.K M nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, liçenca e shoqërisë duhet të jetë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

#### Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P - 2** Ndertime civile dhe industriale.
- **N.P - 7 a,b,c** Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;

#### Për punimet speciale të ndërtimit :

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 2** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S - 12** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

---

Operatorët e huaj duhet të paraqesin njësimin e licencave profesionale që disponojnë (të lëshuara nga vendi i origjinës), pranë Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastrukturës në plotësimin e Licencave Profesionale të kërkuara për ekzekutimin e Kontratës.

2.3.3 **Deshmi për stafin punonjës të operatorit ekonomik**, ku numri mesatar i punonjësve të siguruar të jete jo më i vogël se **12 (dymbëdhjetë)** punonjës për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023** Për këtë duhet të paraqesë:

- **Vërtetimi të lëshuar nga Administrata Tatimore**, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023**.
- **Listepagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore**, Shendetesore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punesimi, për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

1. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, personelin si më poshtë:

- **1 (nje) inxhinier Ndertimi**
- **1 (nje) inxhinier Hidroteknik**
- **1 (nje) inxhinier Mekanik**
- **1 (nje) Arkitekt**
- **1 (nje) inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) inxhinier Gjeodet**

Inxhinierët e mësipërm duhet të jenë në licensën e kompanisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë.( Formularët E-Sig 025/a.1).

**Per kete OE te paraqese:**

- Licensat personale të vlefshme sipas VKM nr. 943, datë 28.12.2016
- CV-të
- Kontrata e punës.
- Diplome
- Licence Profesionale



---

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë pjese të stafit ekspert privat zjarrfikes të Certifikuar për Hartimin e Projekteve të Mbrojtjes nga Zjarri.

**Per kete OE te paraqese:**

- Diplomen
- Certifikaten për ushtrimin e profesionit

Kontrata e punës dhe të figuroje në Formularet E-Sig 025/a.1 për periudhën **Janar 2022 – Gusht 2022**, e kërkuar me sipër.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantiere".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ekuivalente) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (ekuivalent) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
